



PLANI I ZHVILLIMIT I KOMUNES SHISHTAVEC



Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

**PLANI I ZHVILLIMIT I KOMUNES
SHISHTAVEC
(QARKU I KUKESIT)**

Tetor 2012

PARATHËNIE

Plani i Veprimit dhe Zhvillimit i Komunës Shishtavec është realizuar në kuadër të projektit “Fuqizimi i Rolit të Komunitetit në Planifikimin Strategjik për Zhvillimin Lokal” i financuar nga Balkan Trust for Democracy dhe implementuar nga RASP (program Mbeshtetjes së Shoqatave Rurale), dhe është realizuar në bashkëpunim me organizatën Alb-Aid dhe Komunën Shishtavec.

Balkan Trust for Democracy (BTD) është një iniciativë me një histori veprimtare 10 vjeçare, që mbështet demokracinë, qeverisjen e mirë dhe integritimin Euroatlantik në Europën Juglindore. Ky partneritet publiko-privat, që ka fituar mjaft çmime është krijuar fillimisht në vitin 2003 nga German Marshall Fund i SH.B.A, Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Kombëtar (USAID) dhe Fondacioni Steeart Mott.

RASP (Programi i Mbeshtetjes të Shoqatave Rurale) është një organizatë me qendër në Tiranë, misioni i së cilës mbështetet në stimulimin e mundësive për banorët e zonave rurale për të përmirësuar jetesën dhe reduktuar varfërinë, nëpërmjet shfrytëzimit të mirë të burimeve natyrore, kulturore dhe njerezore për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. RASP ka një eksperiencë të gjatë në zhvillimin e projekteve me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit dhe në fokus të këtyre projekteve është zhvillimi i zonave rurale, forcimi i demokracisë dhe rolit të shoqërisë civile në planifikim, hartim dhe implementim të dokumenteve strategjike, planeve të zhvillimit, veprimit të zonave ku ata jetojnë .

Organizata “Alb aid” është një organizatë jo fitimprurëse, me bazë në Kukës, e suksesshme në implementimin e një sere projektesh me karakter social dhe zhvillimor kryesisht në zonat rurale të Shqipërisë Verilindore.

Synimi i këtij dokumenti është të ofrojë Pushtetit vendor, Qeverisë shqiptare, donatorëve bilateral dhe multilateral, organizatave Qeveritare dhe jo Qeveritare një program zhvillimi për promovimin e mbështetjes dhe investimeve të shërbejë si një mekanizëm planifikues, i cili kombinon prioritetet sipas sektoreve dhe fshatrave, prioritetet të cilat janë artikuluar nga drejtues të organeve vendore.

Komuna Shishtavec ka një potencial të madh zhvillimi, me bukuri të vecante natyrore dhe në këtë kuadër Plan i Zhvillimit dhe Veprimit i Komunës Shishtavec synon të përmbledhë të gjitha prioritetet e zonës në një “dokument” të vetëm që do shërbejë si një guidë në zhvillimin e komunes në të ardhmen. Me mbështetjen e pushtetit lokal është realizuar një proces

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

pozitiv për hartimin e këtij plani me nje pjesemarrje te gjere te komunitetit duke zbatuar Kodin e praktikes se mire ne te gjitha hallkat e tij si Percaktimi i axhendes, Draftimi, dhe miratimi, dhe ky process do te vazhdoje edhe me fazat e Implementimit, Monitorimit dhe Riformulimit.

PËRMBAJTJA E LENDES

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec.....	1
Parathënie.....	2
Përmbajtja e lendes	4
Mesazhi I kryetarit të komunës Shishtavec	5
Metodologjia.....	6
Puna Përgatitore	6
Përfshirja e aktorëve kokal në këtë Proces	6
Arritjet e Analizës së Situatës së Tanishme.....	7
Identifikimi i një Vizioni për të ardhmen	7
Identifikimi i Objektivave kryesore.....	8
Identifikimi, Vlerësimi dhe Zgjedhja e Planit të Zhvillimit	8
Plani i Veprimit dhe Shkrimi i Dokumentit të Planit të Zhvillimit.....	9
Zbatimi i Planit Afat-Shkurtër	9
Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit të Planit Afat-Shkurtër	10
Përshtatja e Ndryshimeve e Zhvillimit të Planit Gjatë Fazës së Zbatimit	10
Përfitimet nga Plani i Zhvillimit	11
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	13
Të Dhëna të përgjithshme	15
II ANALIZA E SITUATËS SË KOMUNËS	18
Potencialet e turizmit dhe niveli i zhvillimit aktual	18
III ANALIZA SWOT E SITUATËS	27
IV VIZIONI DHE OBJEKTIVAT.....	28
ANEKS I. Lista e Prioriteteve	37
ANEKS 2. Koncept Ide.....	46
Projekt Ide nr 1.....	46
Projekt Ide nr 2.....	48
Projekt Ide nr 3.....	49
Projekt Ide nr 4.....	50
ANEKSI 3 Plani i Punës për hartimin e planit (Mars –Korrik).....	52
Vendimi i keshillit të komunes	59

MESAZHI I KRYETARIT TË KOMUNËS SHISHTAVEC

Të Nderuar,

Plani afat shkurtër i komunës së Shishtavecit është vazhdimësia e përpjekjeve tona për zhvillimin e komunës. Ky plan ndjek vazhdimësinë e planit të mëparshëm të përgatitur nga UNDP në bashkëpunim me komunën. Plani ndihmon në orientimin e përpjekjeve tona si administratë e komunës, për të ecur në drejtimin e duhur për përmirësimin jetës së banorëve të komunës. Ne kemi një dokument i cili shërben si një pikë referimi për zhvillim.

Unë kam bindjen e plotë tek cilësia e planit të përgatitur nga specialistët e Organizatës Jo Fitimprurëse ALB-AID, e cila në vitet e ardhshme do të jetë pika mbështetëse e administratës së komunës. Gjithashtu, unë kam kënaqësinë time të shpreh se plani është lehtësisht i zbatueshëm.

Përgatitja e planit të zhvillimit ka ndjekur një mënyrë gjithëpërfshirëse të anëtarëve të komunitetit, specialist dhe pjestare të administres së komunës. Përfaqësuesit e komunitetit të fshatrave janë përfshirë thellësisht në diskutimet e nevojave të tyre. Ato ishin shtylla kryesore në ndarjen e prioritetëve pasi njohin problemet e çdo fshati. Përfshirja e antarëve të komunitetit në këtë proces, ka nxitur mjaft demokratizimin e shoqërisë në komunë duke e bërë që administrata e komunës të jetë e hapur me veprimet e që ajo bën, gjithashtu përfaqësuesit e komunitetit e ndien veten pjesë të përgatitjes, zbatimit si dhe në hapat e mëtejshem pjesë e monitorimit të këtij plani zhvillimi.

Gjej mundësinë të shpreh në emër të gjithë komunitetit falenderimet tona për organizatën RASP, specialistët e OJF-së ALB-AID që përgatiten këtë plan, si dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces. Procesi i përgatitjes ka qene një proces i hapur, demokratik dhe gjithëpërfshires ku të gjithë pjesëmarrësit që morën pjesë shprehen lirshëm mendimet e tyre.

Përfundimi i këtij plani dhe miratimi i tij në këshillin e komunës hape një faze të re për komunën dhe komunitetin. Me anë të miratimit në këshillim bëhet zyrtarizimi i planit të zhvillimit. Ky plan do t'ju shërbej të gjithë të interesuarve për të ndërhyrë me projekte në komunë. Realizimi i këtij plani është një procese më vete, që është një sfidë e mirëpritur nga të gjithë ne.

Kryetar i Komunës

Dileman Nela

METODOLOGJIA

Objektivi kryesor në procesin e përgatitjes së planit të zhvillimit afat-shkurtër të komunës së Shishtavecit ka qenë përgatitja e një dokumenti me vlera të vërteta për vendim marrësit, sesa një dokument i zbukuruar me objektiva jo realistë, që nuk i përket kësaj komune. Në metodologjinë e zbatuar për kryerjen e planit të zhvillimit i është dhënë prioritet aktorëve lokalë të mbështesin procesin nga fillimi deri në fund të tij. Gjatë këtij procesi u morën të gjitha masat që përfituesit e planit të zhvillimit të komunës të jenë përfshirë në të gjitha etapat, si dhe të japin kontributin e tyre. Një kujdes i veçantë i është kushtuar mbledhjes së të dhënave nga të gjithë sektorët e përfshirë.

Procesi i përgatitjes së planit të zhvillimit afat-shkurtër për zhvillimin e social- ekonomik të komunës ka kaluar në hapat e përbërë nga të cilët janë të përmbledhur më poshtë;

PUNA PËRGATITORE

Ndërgjegjësimi i anëtarëve të komunitetit në komunën e Shishtavec për rëndësinë e planit afat-shkurtër të zhvillimit, i cili të jetë në një linjë me procesin e zhvillimit rajonal, kombëtar ka për qëllim ngritjen e një bashkëpunimi me partnerët lokal dhe ndërkombëtar. Palët e përfshira në këtë fazë përfshijnë palët e interesit, pjesëtarë nga komuniteti (nga çdo fshat), strukturat e komunës, këshilli i komunës etj.

Takime me përfaqësuesit e zgjedhur të komunës për mënyrën se si do të veprohet me përgatitjen e planit afat-shkurtër të komunës.

Formimi i grupit konsultativ, ky grup është ngritur nga pjesëtarët e komunitetit. Numri i përfaqësimit në grup është bërë në bazë të numrit të popullsisë. Të gjithë anëtarët e zgjedhur në grupin konsultativ nuk ishin anëtarë të ndonjë force politike apo pjesëtarë të administratës së komunës.

Ngritja e grupit qendror për përgatitjen e planit afat-shkurtër të zhvillimit.

PËRFSHIRJA E AKTORËVE KOKAL NË KËTË PROCES

Në të gjitha takimet, mbledhjet e punës, në sesionet e grupeve të punës që janë organizuar gjatë gjithë procesit të përgatitjes së planit të zhvillimit, një vëmendje e veçantë i është kushtuar pjesëmarrjes së përfaqësuesve të grupeve me bazë komunitare. Procesi ka qenë gjithmonë i hapur për të gjithë pjesëmarrësit për të bërë sugjerime ose për të dhënë kontributin e tyre në këtë proces. Janë mirëpritur të gjitha vërejtjet apo sugjerimet e bëra.

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

Pjesëmarrësit në këtë proces përfaqësonin organizatat me bazë komunitare, organet e pushtetit lokal, si dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.

Në fakt vlen të theksohet në veçanti se në të gjitha takimet, mbledhjet e punës, në sesionet e grupeve të punës pati pjesëmarrje të grave, por pjesëmarrja e saj dhe zëri i tyre ishte shumë i vogël. Kjo për shkak të barrierave të mentalitetit të zonës si dhe nga mos zhvillimi ekonomik i saj, gruaja është akoma e pafuqishme të përçojë fuqishëm zërin e saj, gjë që u vu re gjatë gjithë procesit të zhvillimit të planit afat -shkurtër të zhvillimit.

ARRITJET E ANALIZËS SË SITUATËS SË TANISHME

Analiza e situatës së tanishme është kryer si më poshtë:

- a. plotësimi i një formulari/pyetësori nga të gjithë aktorët lokal (pjesëmarrësit në këtë proces).
- b. identifikimi dhe strukturimi i pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve që janë të njohura me shkurtime si analiza SËOT.
- c. diskutime me hollësi nga grupet e punës për të identifikuar prioritetet e zonave (fshatrave të komunës).

Të gjitha të dhënat e mbledhura janë kontrolluar nëse është informacion i vlefshëm i saktë dhe pastaj strukturat kanë vazhduar mënyrën e ngritjes së një pike të dhënave. Ata janë përdorur për të vlerësuar ndikimin e ndërhyrjeve të propozuara dhe identifikimin e treguesve lokal për të matur progresin e bërë. Të gjitha këto elementë të zgjedhur kanë kontribuar për përmirësimin e cilësisë të procesit të planifikimit. Një literaturë mjaft e dobishme është mbledhur nga literatura lokale e Kukësit (studime, libra të ndryshëm në fusha të ndryshme që janë të përgatitura nga individ apo institucione) si dhe interneti. Por duhet theksuar se materiali i publikuar në internet është mjaftë i kufizuar.

IDENTIFIKIMI I NJË VIZIONI PËR TË ARDHMEN

Një vizion i qartë për të ardhmen e komunës ka një rëndësi të veçantë në procesin e planit afat -shkurtër të zhvillimit. Dëshira e përbashkët të komunitetit dhe përfshirja aktive për një të ardhme më të mirë se ajo e sotmja është bërë faktor frymëzuese për përpjekjet e suksesshme të zbatimit të programit dhe projekteve të identifikuara, të vlerësuara si prioritet për zhvillim lokal të qëndrueshëm. Është mjaft e rëndësishme që komuna të ece me hapa të njëjtë me atë të rrethit dhe Qarkut Kukës.

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

Identifikimi i vizionit të komunës së Shishtavecit erdhi natyrshëm si një rezultat i analizës së situatës me pjesëmarrësit në takime, në mbledhjet e punës, gjatë sesioneve të ndryshme të punës për të zhvilluar konceptin e planit të zhvillimit.

IDENTIFIKIMI I OBJEKTIVAVE KRYESORE

Identifikimi i objektivave kryesor, i strategjisë së planit të zhvillimit ka filluar me identifikimin e vizionit të komunës, analizën SËOT dhe mbledhjen e gjetjeve që janë marrë nga burime të vëna në dispozicion, potenciale, mundësi, pozicioni gjeografik i saj. Të gjitha këto së bashku kontribuojnë në integrimin e kësaj zone me tregun lokal dhe më gjerë.

Objektivat janë klasifikuar në tre zona kryesore dhe së bashku me projektet dhe treguesit e progresit janë strukturuar në formë e një matrice ose të një kornize plan zhvillimi.

IDENTIFIKIMI, VLERËSIMI DHE ZGJEDHJA E PLANIT TË ZHVILLIMIT

Strategjitë janë veprime, të cilat kontribuojnë në zbatimin e përmbushjes së vizionit dhe të objektivave strategjike për zhvillimin e zonës.

Orientimi i zhvillimit të komunës së Shishtavecit, siç është bërë i pranishëm në përshkrimin e vizionit, qëndron në atë të prioritetit të zhvillimit të blegtorisë, përpunimit të produkteve të qumështit, pyllëzime si dhe inkurajimi i turizmit, si duke mos anashkaluar dhe fushat e tjera. Shtrirja e zonës, terreni malor, kullota në bjeshkët e fshatrave të komunës i japin një mundësi për të mbarështuar blegtori të imët. Zotërimi i këtyre burimeve natyrore ka tërhequr vëmendjen e disa banorëve të cilët kanë patur sukses në mbarështimin e blegtorisë së imët (dele etj), të cilët kanë krijuar traditën e tyre në këtë fushë. Blegtoria është parë si një mundësi e vërtetë për të krijuar të ardhura lokale në familje përmes shitjeve të bagëtive dhe produkteve të tyre në tregun lokal.

Pavarësisht nga vlerësimi i treguar nga banorët lokal për zhvillimit të blegtorisë, vihet re një nivel në rritje të ndërgjegjesimit të për rëndësinë dhe vlerën e bimëve medicinale, bujqësisë familjare (kjo tepër e kufizuar për shkak të terrenit të thyer malorë). Gjithashtu vihet re një nivel më të lartë kujdesi ndaj habitatit natyror dhe forcimin të strukturës lokale për efektshmërinë në mbrojtjen e mjedisit.

PLANI I VEPRIMIT DHE SHKRIMI I DOKUMENTIT TË PLANIT TË ZHVILLIMIT

Gjatë zhvillimit të takimeve, mbledhjeve të punës me grupet e punës u ngritën grupet e punës të cilët ishin përgjegjës për secilin objektiv, ndërsa grupi i financës (zyra e financës së komunës) ishte në mbështetje të gjitha grupeve. Të gjitha grupet e punës së ngritura pas kësaj për identifikimin e nën prioriteteve, programeve dhe projekteve për temat e fokusuara. Në një numër i rasteve të projekt ideve mund të zhvillohen në të ardhmen projekte të plota zhvillimi për zonën.

Përgatitja dhe strukturimi i këtij plan afat-shkurtër zhvillimi është bërë nga punonjësit e OJF ALB-AID, Riza Ademaj, Gentian Palushi dhe grupet e punës.

ZBATIMI I PLANIT AFAT-SHKURTËR

Miratohet plani afat-shkurtër i zhvillimit nga këshilli i komunës. Zbatimi i këtij plani do të jetë i mundur përmes:

- projekteve vjetore të planifikuara për zbatim në komunë, të cilat duhet të jenë në përputhje me planin afat-shkurtër dhe zbatimi i tij të merret në konsideratë me zhvillimet më të fundit në komunë.
- vazhdimin të përfshirjes të të gjithë aktorëve mes qeverisjes lokale (komunë) që kanë role themelore.
- caktimit të fondeve nga qeverisja lokale
- ngritjes së një partneriteti dhe kërkimit për fonde nga donatorë të huaj. Ky plan do të shërbejë si një “kartë identiteti” e cila do të luaj një rolë të veçantë duke siguruar informacionin e nevojshëm për çdo prioritet, sektor dhe territor të komunës.

Në përputhje me prioritetet e identifikuar dhe burimet aktuale, administrata e komunës është e gatshme të punojë me këtë dokument. Megjithatë për të patur suksese në ngritjen e fondeve nga donatorë të ndryshëm, kryesisht të huaj kërkohet dhe është si detyrë për rritje dhe përmirësim të kapaciteteve.

Një nga detyrat më të rëndësishme të identifikuar gjatë përgatitjes dhe miratimit të planit afat-shkurtër të zhvillimit, ka të bëjë me nevojat për ngritjen e kapacitetëve dhe ruajtjen e burimeve njerëzore në administrimin lokal. Këtij aspekti duhet ti kushtohet një vëmendje e veçantë nga vendim marrësit, për garantimin e vazhdimësisë së punës së kualifikuar të stafit në

linjë me veprimet e ligjshme të statusit të punonjësve publik dhe praktikat më të mira të vendeve të tjera.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PLANIT AFAT-SHKURTËR

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit afat-shkurtër të zhvillimit po aq mirë sa dhe përshtatjes ose ndryshimeve për justifikimin e arsyeve dhe me marrëveshjet e të gjithë aktorëve përkatës është një proces i natyrshëm.

Përshtatja e treguesve për vlerësimin e ndikimet e pritura nga plani i zhvillimit krijojnë një garanci për sukses në zbatim. Treguesit e identifikuar si sukses janë të integruar në kornizën e planit.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të planit të zhvillimit do të kryet në mënyrë të vazhdueshme përmes monitorimit dhe vlerësimit me bazë vjetore të planit të zhvillimit.

Gjithashtu është e rëndësishme gjatë fazës së zbatimit, përveç vlerësimit të procedurës për seleksionimin e projekteve për zbatim dhe efektshmëria e përdorimit të kostove të vëna përballë rezultateve të pritura të jetë një vlerësim i përafërt. Ky proces duhet të vazhdohet nga administrata e komunës, këshilli i komunës, krye plakuri i fshatit, organizatat me bazë komunitare, këshilli konsultativ i ngritur dhe është i hapur për gjithë komunitetin.

PËRSHTATJA E NDRYSHIMEVE E ZHVILLIMIT TË PLANIT GJATË FAZËS SË ZBATIMIT

Është më se normale që plani i zhvillimit afat-shkurtër mund të ketë nevojë të përshtatet ose ndryshohet në saj të arsyeve të brendshme e të jashtme që janë të pamundura të parashikohen në momentin e përgatitjes.

Procesi i planit vjetor përben një mundësi shumë të mirë për rishikimin dhe përmirësimin e objektivave kryesore afat shkurtër të komunës. Ky proces duhet të kryhet me pjesëmarrjen e të gjithë aktoreve lokal dhe gjetjen e një konsensusi.

Pavarësisht eksperiencës së krijuar në komunën e Shishtavecit me përparësinë e platformës së zhvillimit megjithatë ka qenë mjaft e dobishme ndihma e dhënë për përgatitjen e planit të zhvillimit që është shtrirë përgjatë zhvillimit të fazës së zbatimit.

PËRFITIMET NGA PLANI I ZHVILLIMIT

Përfitimi nga përgatitja e planit strategjik janë të shumta. Më poshtë janë të listuar një numër prej tyre;

- procesi i përgatitjes së planit afat-shkurtër të zhvillimit ishte një eksperience pozitive me kontribute reale për ngritjen e kapaciteteve të OJF-s, pushtetit lokal, dhe aktorëve të tjerë duke influencuar në mënyrë pozitive në mentalitet dhe në praktikat e funksionimit. Kjo ishte arritur përmes takimeve, zbatimit të metodës së pjesëmarrjes për vlerësimin e nevojave, të procesit të identifikimit të prioritetëve.
- plani afat-shkurtër i zhvillimit është rezultat i vlerësimit të gjithë burimeve potenciale për zhvillim në tërë shtrirjen gjeografike të komunës me qëllim harmonizimin e sektorëve të bujqësisë, bagëtisë, mjedisit, në shtrirjen e prodhimeve të tyre në tregun lokal, përmirësimi i infrastrukturës, shërbimeve publike, si dhe ndihma drejtë familjeve dhe individëve në vështirësi dhe përmirësimi i cilësisë së qeverisjes.
- përcaktimi i qartë i prioritetëve në planin afat-shkurtër të zhvillimit lehtëson përgatitjen e planeve vjetore të zhvillimit duke i përfshirë në projektet tashmë të identifikuar.
- dokumenti i planit të zhvillimit është rezultat i kontributit të autoriteteve lokale të komunës, OJF-së, CBO, kryetarëve të fshatrave dhe anëtarëve të komunitetit të përfshirë në këtë proces. Pjesëmarrja e gjerë në procesin e rritjes së transparencës së marrjes së vendimeve, përpjekjet e koordinimit dhe kontributin e të gjithë aktorëve dhe donatorëve të interesuar në zhvillimin e zonës, përmirësimin e përgjegjësisë dhe besimin e komunitetit në rezultatet e administratës lokale, në një nivel më të lartë të qeverisjes.
- pasja e një plan zhvillimi afat-shkurtër përmirëson besueshmërinë, seriozitetin e qeverisë lokale në ngritjen e bashkëpunimit me institucione të ndryshme, donatorë, agjenci zhvillimi dhe partnerë të tjerë nga jashtë komunës që do të përmirësojnë mundësitë për tërheqjen e investimeve, sjelljen e të ardhurave më të mëdha për komunën dhe komunitetin.

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

- përgatitja e plan zhvillimit afat-shkurtë në baza të matshme me treguesit e ndryshimeve është një kontribut i vërtetë për ngritjen e një mënyre komunikimi të frytshme midis aktorëve lokal.
- pjesëmarrësit e përfaqësuesve lokal të gjithë forcave politike që kanë anëtarësimin në këshill të komunës dhe kontributi i tyre në përgatitjen e planit të zhvillimit siguron qëndrueshmëri për një orientim zhvillimi të komunës.
- përgatitja e plan zhvillimit i jep një kontribut për identifikimin, vlerësimin, strukturimin e një informimi të komunës, vlerësim të treguesve të zhvillimit, i cili mund të konsiderohet si një bazë e mirë për themelimin e të dhënave të besueshme për komunën në të ardhmen. Përfshirja e drejtë për drejtë për gjetjen e informacionit dhe vlefshmërinë e tij ishte gjithashtu një eksperience mjaftë e çmuar për administratën lokale.

TË DHENA TË PËRGJITHSHME

Historiku

Shishtaveci përmendet në vitin 1355 si pronë e Manastirit të Hilandarit të Malit të Shenjtë në Greqi. Përmendet në vazhdimësi në vitet 1455, 1571, 1591 e më pas si njëri prej fshatrave më të mëdhenj të krahinës së Gorës. Merr pjesë aktive në qëndresat e popullit të Gorës e të gjithë Kukësit kundër pushtuesve turq e srbë në vitet 1910, 1911, 1912. Dy prej luftëtarëve të rënë në këto përpjekje janë shpallur dëshmor të atdheut. Klerikët dhe patriotët e këtij fshati,



kanë ndërhyrë disa herë pranë Komisionit ndërkombëtar për saktësimin e kufijve në kuadër të vendimeve të Konferencës së Londrës për kalimin e gjithë Gorës brenda juridiksionit politik të shtetit shqiptar. Përfshirja e një pjese të Gorës (pjesa e Kukësit) brenda këtij juridiksioni është edhe meritë e tyre mes të cilëve mund të veçojmë Mulla Qamilin e këtij fshati. Që në mars të vitit 1923, kur përfundimisht u vendosën kufijtë sotëm politik të Shqipërisë, Shishtaveci u caktua si qendër e Komunës së Gorës duke u kthyer në vazhdim dhe si qendër kryesore e saj. Më vonë bëhet qendër lokalitet, qendër e fshatit të bashkuar dhe e kooperativës së Bashkuar dhe që nga viti 1992, qendër e komune me të njëjtin emër ku përfshihen fshatrat Borje, Shishtavec, Cërnelevë, Oreshkë, Kollovoz, Shtreze e Novosej. Në zhvillimet politike e 1922 – 1924, Shishtaveci përfshihet në anën e opozitës duke ndikuar në fitoren e Avni Rustemit si

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

deputet i nënprefektur/s së Lumës ku bënte pjesë edhe Shishtavec. Në Shishtavec, në vitin 1924, u hap shkolla e parë fillore shqipe për krahinën e Gorës dhe në vitin 1952, shkolla 7 – vjeçare. Shumë djem të Shishtavecit u mobilizuan në radhët e ushtrisë partizane në vitet 1942 – 1944, disa prej të cilëve ranë dëshmorë.

Natyra

Shishtavec i është dhe vendi bukurive të rralla natyrore. Në pak vende mund të gjenden bukuri që ofrojnë bjeshka e Shishtavecit si Murga, Guri i Mëngjesi, Fusha e tij, apo lugina e Lumit Ilina Reka.

Shishtavec i përfaqëson pikën më optimale të zonave Gorë, Bushtricë për në Kosovë për këmbime të gjithfarta.

Në se flasim për turizmin ndërkufitar apo marrëdhënie të tjera në këtë hapësirë, sërish Shishtavec i ka përparësi të dukshme, për shkak të pozicionit, potencialeve njerëzore, ekonomike e kulturore.

Tradita

a.Puna

Banorët e Shishtavecit dallohen për pjesën e Gorës së Kukësit për mbarështrimin e deles rudë. Vetëm në këtë fshat ka pas familje si Zhivko (Murati) dhe Bala që kanë mbajtur disa mijëra dele dhe që i kanë shtegtuar rregullisht në kullotat dimërore të Selaniku. Këta banorë janë dalluar për mbarështrimin e kuajve dhe të gjedhit.

Kanë kultivuar me shumë sukses thekrën dhe pataten. Sa i takon patates, në vitet 70 ky fshat u bë një nga prodhuesit më të mëdhenj të kësaj kulture. Shishtavecasi janë shquar si ëmbëltor dhe guzhinierë të aftë në vendet ku e kanë praktikuar mërgimin ekonomik si Greqi, Egjipt, Bullgari etj.

Shumë prej Shishtavecave janë shquar si mjeshtër të prodhimnit apo riparimit të armëve, me të cilat furnizoheshin kryesisht kaçakët apo luftëtarët e e pavarësisë së Shqipërisë. Në Shishtavec vërtetohen sipërmarrës për grumbullimin e garantuar të prodhimnit të një lloj vareteti elbi që përdorej për birra. Në se flasim për tregti në kuptimin e mirfilltë të saj, duhet ti referohemi sërish Shishtavecit. Për të plotësuar nevojat e fshatit e të fshatrave përreth, më i madhi për zonën e Gorës së Kukësit, këtu kanë vepruar heqim (mjekë popullor, mjek të sëmundjeve të kafshëve, nallban, zejtarë të fushave të tjera).

Kultura

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

Shishtavec i ka një traditë në higjienën dhe mirëmbajtjen e shtëpive të zonës. Gratë e Shishtavecit janë të njohura për pastërtinë e shtëpisë. Gratë e Shishtavecit janë mjeshtrë të gatimit të gjellrave tradicionale të zonës dhe të tekstileve popullore. Grupet e valleve popullore të këtij fshati (meshkuj e femra) kanë qenë protagonistë dhe shumë herë fitues të festivaleve folklorike të organizuara në shkallë rrethi e vendi që nga viti 1951, kur u organizua i pari aktivitet i këtij lloji. Në vitin 1957, grupi i valleve të shishtavecit (meshkuj) mori pjesë në festivalin botëror të rinisë e studentëve të organizuar në Moskë. Valltarë virtuoz të këtij fshati si Sali Grisha e Ali Kingji do të mbahen në mend për kohë të gjatë. Në Shishtavec ka ekzistuar tradita e karnavaleve që mund të riaktivizohet. Një element tjetër i traditës janë organizimi i dasmave, ku shfaqen mjaft elemente tradicionale si në gatim, valle, zakone tj

Sport

Mes klubeve sportive të Kukësit ndër më të dalluarit ai “Morava “ i Shishtavecit i krijuar pas viti 1944. Sportistët e këtij klubi, bashkë me atë të Kukësit për shumë kohë i kanë dhënë tonin jetës sportive të Kukësit. Në Shishtavec mund të flasim për tradita sportive të spikatura në mundje, atletikë, futboll, lojra etj por dy mbeten shumë evidente: Rëshqitja me Ski dhe gara e kuajve. Në Shishtavec ekziston pista e rëshqitjes me ski ku janë zhvilluar shumë kampionate lokale e kombëtare. Ekipi i skiatorëve të Shishtavecit që nga viti 1952, shumë herë ka dalë kampion vendi.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Sipërfaqja e komunës është 6360.7 ha në një territor prej 59 km². Rreth 43.8% e të gjithë territorit të komunes Shishtavec përbëhet nga pyjet, tokat pyjore dhe djerrinat, ose rreth 2789.3 ha të sipërfaqes së përgjithshme. Prej kësaj sipërfaqe, me pyje janë 1252.4 ha ose 19.7 %, toka te tjera pyjore janë 48.9 ha ose 0.77%, dhe djerrina 1536.9 ha ose 24.16%.

Popullsia e Shishtavecit nuk ka pasur lëvizje të theksuara në vite, por duhet të theksojmë se kjo komunë ka një numër të madh emigrantësh kryesisht në Angli.

Tabela 1: Popullsia e komunës Shishtavec

Nr	Komuna	Popullsia në vitin 1997	Popullsia në vitin 2005	Popullsia në vitin 2012
1	Shishtavec	NA	NA	5040

Tabela 2: Të dhëna 2012

Nr	Fshatrat	Popullsia	Meshkuj	Femra	Numri i familjeve	Mesatarja e personave për familje
1	Shishtavec	1324	646	678	249	5
2	Novosej	1217	580	637	230	5
3	Borje	957	512	445	201	6
4	Kollovoz	312	163	149	85	4
5	Oreshke	408	201	207	102	5
6	Cernaleve	429	216	213	107	6
7	Shtrezë	371	169	202	90	7
Total		5040	2509	2531	1064	5

Pozicioni Gjeografik

Shishtaveci është një nga zonat malore më të thella. Vendbanimet shtrihen kryesisht në pjesën veriore e veri-lindore mbi tarracat e luginave që e përshkojnë. Qendra kryesore të banimit janë Shishtaveci(Qendra) Zapodi, Shishtaveci, Borja etj. Nga bimët bujqësore mbillen thekra, tershëra dhe në veçanti Patatja.

Komuna Shishtavec shtrihet në lartësinë 1330-1700 m dhe ka një pjerrësi të vogël në drejtim veri-lindje për gropën e Shishtavecit duke u hapur drejt pellgut të Prizrenit. Në veri-perëndim një rradhë depresjonesh te kontaktit geo-tektamik si ai i Orgjostit, Shishtavecit e Tërshanës e ndajnë nga kurrizi malor i Koritnikut- Kolesjanit, kurse në jug-perëndim mbyllet me kurrizin e Kallabakit. Pjesa qëndrore e kësaj pllaje, ajo midis Kroit te

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

bardhë e Shishtavecit karakterizohet nga një reliev shumë i butë. Kurse në perëndim mbydhjet me kurrizin e Luspave të Kollozit, Shtrezez e Brekisë.

Klima; Pllaja e Shishtavecit ashtu si gjithë vargu në terësi dallohet për një klimë malore me dimër të ashpër e të lagesht, Kurse verë relative të thatë e të fresket. Temperatura mesatare vjetore është 7.1°C; Janar -10,1 °C dhe e Korrikut 18 °C. Sasia mesatare vjetore e rreshjeve është 858 mm, një pjesë e madhe e të cilave bie në formë bore. Lartësia mesatare maksimale e shtresës së borës këtu arrijnë 100-160cm.

Ka reliev tepër të thyer, verë të freskët dhe dimër të ftohtë dhe të gjatë. Bujqësia blegtoria dhe zëjtaria kanë qenë bazë të ekonomisë. Është populluar gjatë mesjetës.

Pllanja e Shishtavecit një nga më të mëdhatë e vendit tonë, ka formën vezake në drejtim Verilindje-jugperëndim, gjatësia 15 km dhe gjerësia 11 km. Gërqet e shumta akullnajore që copëtojnë pjesën lindore të kësaj pllaje përfundojnë drejt pjesës qendrore të saj duke shënuar fillimet e perenjve dhe shkaktuar zgjerime lokale të kësaj pllaje, si ai i Shishtavecit. Këtu formohen edhe luginat e përrnjve më të njëjtin emër. Kurrizi perëndimor; Breki-Kollovoz kufizon pllajën e pykezuar mbi depresionet e kontaktit të reshjeve me gelqeroret e Koritnikut-Gjallicës. Në këto depresionet e kontaktit të reshjeve ku kalojnë deget e lumit të Lumes, si perroi i Orgjostit, i Borjes, i Shishtavecit dhe i Shishtavecit.

Burimet Ujore; Komuna Shishtavec i përket një zone të pasur burime ujore, të cilat në një reliev kryesisht të thyer formojnë shumë perrenjë.

II ANALIZA E SITUATËS SË KOMUNËS

POTENCIALET E TURIZMIT DHE NIVELI I ZHVILLIMIT AKTUAL

Turizmi përbën prioritetin e parë për zhvillimin e Komunës së Shishtavecit, e cila zotëron burime të virgjëra natyrore e të pa shfrytëzuara si;

- Pllaja e Shishtavec, Novosej
- Burimet natyrore dhe rezervari (në Novosej)
- Livadhet dhe kullotat
- Monumentet natyrore
- Pyjet e mështeknës në Shishtavec dhe i dushkut në Novosej
- Guri i mëngjesit



Zhvillimi i turizmit shoqërohet me zhvillimin e prodhimeve bujqësore, blegtorale, riparimin, përmirësimin e shtëpive të banorëve, rregullimin/ngritjen e vendeve të përshtatshme për kalimin e kohës së lirë të vizitorëve, si dhe përmirësimi i prodhimeve lokale etj.

Promovimi, përmirësimi i edukimit dhe nivelit të kulturës tek banorët e zonës për zhvillimin e turizmit, e pritjes së turistëve, nivelin e jetesës dhe konceptet për zhvillimin lokal të zonës së tyre, organizimin e jetës në vendin e trashëguar, megjithëse duhet të konsolidohet rritja e aftësive profesionale dhe njohuritë e banorëve për ekonominë e tregut e përshtatjes së saj me zonën.

Komuna përmban zona të mbrojtura dhe monumentet e natyrës të propozuara “Zona të Mbrojtura” në Qarkun e Kukësit miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 676 datë. 20.12. 2002. Zona të tilla janë si më poshtë:

- Mështekna¹ e Shishtavecit 33 ha dhe liqen² i Kallabakut.
- Pylli i dushkut Novosej 3 ha.

¹ Masivi i mështeknës së Shishtavecit

² Rezervar i Kallabakut

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

- Guri i Mëngjesit-Shishtavec.
- Guri i Shqipes (Borje)

Pikat e forta për zhvillimin e turizmit

Turizmi i zonës si destinacion ofron tipare të tilal si lartësia e lartë mbi nivelin e detit, flora e pasur, vende për kalimin e kohës së lirë, natyra e pa prekur, vend i pa njohur shumë vizitorët vendas dhe të huaj, nuk ka ndërtime të betonizuara, natyrë e paprekur. Lëndina të përshtatshme për të organizuar aktivitete të ndryshme. Kampingu i ngritur në Novosej nga UNDP është një tjetër pikë e fortë e turizmit të zonës.

Pikat e dobëta të turizmit

1. kultura e shërbimit nuk është në nivelet që kërkohet
2. shërbimet dhe akomodimi për turistët mungojnë
3. mungon informacioni për të gjithë zonën
4. në disa pjesë të zonës mungon sinjali i telefonit celular
5. promovimi i turizmit të zonës është në nivel shumë të ulët
6. mungojnë guidat turistike për zonën
7. rruga kombëtare Kukës –Shishtavec akoma e pa përfunduar

Kapacitet Ekzistuese

- Kampingu në Novosej
- Bar-restorant në Shishtavec dhe Novosej 4
- Shtëpi pritëse për turiste Shishtavec 7
- Në ndërtim e sipër një Hotel tek rezervari i Kallabakut, në Novosej

Bujqësia

Bujqësia nuk zë një vend të rëndësishëm në Komunën e Shishtavecit. Toka në fshatrat e komunës më shumë përdoret për kullota për bagëtinë e imët. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 1916 ha. Kultura më të rëndësishme bujqësore në zonë janë; patatja, thekra, rrallë misri dhe fasulja. Duke qenë sipërfaqe e kufizuar toke aspak e mekanizuar, për shkak të kushteve klimatike, jo të gjitha kulturat bujqësore kultivohen. Në këto rrethana banorët janë kryesisht të përqendruar në kultivimin e patates. Patatja është një nga kulturat më të kultivuara në zonë ku banorët sigurojnë një pjesë të ardhurash. Në kultivimin e saj banorët kanë traditë të hershme, pasi kushtet klimatike -tokësore janë mjaft të favorshme. Në këtë zonë mbillen sipërfaqe relativisht të mëdha, madje mund të themi të barabarta me sipërfaqen e mbjellë me atë të thekrës pasi ato qarkullojnë njëra –tjetrën. Vihet re se në komunën e Shishtavecit rendimentet e patates janë të kënaqshme, ndonëse banorët e komunës kanë hasur mjaft vështirësi në nxjerrjen në treg të kësaj kulture për shkak të superprodhimit dhe taksave të ulët të importit për këtë kulturë. Infrastruktura e dobët si dhe futja e kësaj kulture nga vende të tjera fqinje e ka bërë më pak konkurruese në tregun lokal, pasi kjo kulturë del në treg me koste më të lartë se sa ajo e importit, megjithëse mbetet një ndër prodhimet bio të Shqipërisë.

Ujitja; Në Komunën e Shishtavecit ndonëse kapacitetet ujore janë të pranishme në zonë, sistemi i vaditjes nuk funksionon dhe gjatë takimeve të organizuara në kuadër të përgatitjes së këtij plani zhvillimi del si prioritet rikonstruksioni dhe ndërtimi i kanaleve ujitës. Kanalet vaditëse në Shishtavec dhe Borje janë plotësisht të dëmtuara megjithëse ato kanë funksionuar gjatë sistemit komunist.

Mekanizimi i bujqësisë; Bujqësia moderne arrin të prodhojë me kosto të ulët dhe përdor më pak krahun e punës. Në komunë për sa i përket mekanizimit bujqësor, mund të themi se nuk ekziston fare, qoftë në drejtim të numrit të fuqisë motorike por dhe mungesës së agregateve. Në të gjithë zonën toka bujqësore punohet me mjete primitive si parmendë dhe me krahë.

Kimizimi i bujqësisë; Përbërja e tokës është e varfër në elementin fosforit, e varfër e mesme në elementin e azotit, e mesme dhe e pasur në elementin e potasit³. Këta elementë tregojnë për një prodhim të ulët. Për të marrë prodhim të mirë banorët bëjnë plehërim organik, kurse plehërimi kimik pas vitit 1990, bëhet rrallë ose nuk bëhet fare.

Mbrojtja e bimëve; Në komunën e Shishtavecit, bimët e arave dëmtohen sistematikisht nga sëmundje të ndryshme, të tilla si; dëmtimi nga barërat e këqija, që ulin ndjeshëm rendimentin. Ndërsa dëmtues është buburreci i kolorados që dëmton rëndë kulturën e patates. Banorët mundohen të blejnë vetë pesticidet për mbrojtjen e bimëve kryesisht të patates. Nga drejtoria e bujqësisë së Kukësit nuk subvencionohen për blerjen e pesticideve.

Blegtoria; Blegtoria në Komunën e Shishtavecit është pjesë e rëndësishme e ekonomisë së zonës pasi siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave. Këto të ardhura fermeri i siguron nga mishi, ndërsa produktet e nënproduktet e tjera përdoren kryesisht për përdorim familjar dhe nuk tregtohen në treg. Në fshatrat e Shishtavecit, Novosejt, Borjes, Shtrezës etj mbarështrohet delja rudë. Në të gjithë komunën ka mbi 20 familje që mbajnë më shumë se 100 dele.

Në këtë zonë banorët kryesisht mbarështojnë gjedh, të leshta dhe të dhirta. Gjedhi mbarështohet në numër të vogël në nivel komunë. Banorët e mbarështojnë në numër të vogël vetëm për nevojat familjare. Gjedhi në këtë zonë mbarështohet lehtë me kullotje natyrore gjatë periudhës së pranverës, verës dhe vjeshtës, kurse në dimër me regjim stallor. Familjet grumbullojnë rezerva dimërore për mbarështim.

³ Meçaj, Nasip; Dida, Maxhun; Qarku i Kukësit, fq 87, Shtëpia Botuese Toena, Tiranë 2004

Dhentë përdoren kryesisht për prodhim mishi, kryesisht për treg lokal në Kukës, kurse qumështi dhe leshi për përdorim familjar, shumë pak tregtohet ose aspak. Banorët shfrytëzojnë mjaft mirë kullotat natyrore, gjatë periudhës së verës, kurse dimrit fermerët që kanë numër të madh i shtegtojnë në zona të ulëta. Raca më përhapur në zonë është tipi i deles “Rude”.

Kullota dhe Pyje

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të komunes shishtavec është 6360.7 ha. Rreth 43.8% e të gjithë territorit të komunes Shishtavec përbëhet nga pyjet, tokat pyjore dhe djerrinat, ose rreth 2789.3 ha të sipërfaqes së përgjithshme. Prej kësaj sipërfaqe, me pyje janë 1252.4 ha ose 19.7 %, toka të tjera pyjore janë 48.9 ha ose 0.77%, dhe djerrina 1536.9 ha ose 24.16%.

Kullotat zene një vend të rëndësishëm në territorin e komunes Shishtavec me rreth 1133.8 ha ose 17.83% dhe livadhet rreth 210.8 ha ose 3.31%

Si në të gjithë komunat e tjera të Qarkut dhe në komunën e Shishtavecit janë dëmtuar pyje si rrjedhim i shfrytëzimit të paplanifikuar të natyrës, prerjes, pa kriter të tyre nga banorët.

Bimët Mjekësore; Mjedisi i kësaj zone është mjaft e larmishme. Në komunën Shishtavec në formë natyrale janë bimë medicinale si, shkëm, qershizë. Disa banorë gjatë stinës së verës angazhohen në mbledhjen e qershizë, të cilën e shesin në tregun lokal. Kjo shërben për të rritur të ardhurat e tyre familjare. Numër i banorëve që merren me mbledhjen e qershizë së egër është i vogël.

Kafshët e egra; Bota shtazore e komunës së Shishtavecit është mjaft e pasur, ndonëse ka pasur dëmtime pas vitit 1990, por ajo ka përfaqësuesit e vet. Kafshët grabitqare që mund të gjenden në këtë zonë është ujku, dhelpra, rrëqebulli, macja e egër, kunadhja, qelbësi etj. Ujku përhapjen më të madhe e ka në brendësi të pyjeve, veçanërisht në pyje të dendur. Kurse dhelpra mund të gjendet dhe afër zonave të fshatrave. Kafshë të tjera jo grabitqare janë derri i egër, lepuri, ketri, dhia e egër dhe rrallë herë kaprolli. Ndërsa shpendë janë sorra, laraska, kukumjaçka, bufi, skifteri, hutini, shqiponja, pëllumbi i egër, turtulli dhe rrallë herë gjendet thëllëza e malit.

Shërbimet Bazë dhe Infrastruktura

Shërbimi shëndetësor; në këtë komunë ka funksionuar shërbimit bazë shëndetësor. Komuna ka trashëguar një sistem shëndetësor me infrastrukturë të dobët, pa mjedise të përshtatshme për mjekun e familjes

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

dhe infermieren për të kryer shërbimet ndaj banorëve. Në vitet e fundit është ngritur qendra shëndetësore.

Tabela Shërbimi mjekësor

Nr	Emri i fshatrave	Popullsia	Numri i Mjekëve	Numri i Infermiereve	Ambulancat Shëndetësore
1	Shishtavec	1324	1	2	1
2	Novosej	1217	0	1	1
3	Borje	957	0	1	1
4	Kollovoz	312	0	1	0
5	Oreshke	408	0	1	0
6	Shtrezë	429	0	0	0
0	Cernaleve	371	0	0	0
Total		5040	1	6	3

Niveli i vdekshmërisë foshnjore në nivel komune për vitin 2010 është 0.

Personeli i shërbimit të shëndetit është trajnuar here pas here. Qendrat shëndetësore janë të pajisura me mjetet e nevojshme bazë. Stafit mesëm mjekësor përgjigjet nevojave të komunitetit për shërbime, në të gjitha fshatrat e komunës. Vaksinimi është bërë sipas datave të planifikuara për popullsinë.

Sfidat e shërbimit shëndetësor në komunë:

1. mungesa e një qendre shëndetësore në komunë.
2. nevojitet më shumë se një mjek familje në komunë, fshatrat e komunës janë të shtrirë në një sipërfaqe të madhe dhe në një terren të thyer.
3. pajisja me një auto-ambulancë

Familje me Ndihmë Ekonomike ;

Kukësi është një ndër Qarqet më të varfra në Shqipëri. Komuna e Shishtavecit si pjesë e Qarkut Kukës, ka trashëguar dhe akoma është

Plani i zhvillimit i komunes Shishtavec

komuna me një nivel të lartë varfërie. Sipas të dhënave të marra nga Komuna Shishtavec për vitin 2012 janë 517 familje me ndihmë ekonomike ose rreth 50 % e numrit total të familjeve. Pjesa më e madhe e familjeve të komunës jetojnë në varfëri të plotë. Familjet janë me numër të lartë anëtarësh. Me zhvillimin e ekonomisë lokale të komunës pritet ulja e papunësisë në zonë dhe ulja e numrit të familjeve nga skema e ndihmës sociale.

Tabela Familjeve me ndihmë ekonomike

Nr	Fshati	Popullsia	Numri i Familjeve që Trajtohen me Ndihmë Ekonomike
1	Shishtavec	1324	107
2	Novosej	1217	98
3	Borje	957	132
4	Kollovoz	312	32
5	Shtreze	408	41
6	Cerenaleve	429	54
7	Oreshke	371	53
Total		5040	517

